

**“Blloku i keq”
s’fillon e s’mbaron
me Nazim Blacën!**

FACE 3

Shkruan:
Rrustem MUSTAFA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OSMANI NË SHBA: TRUMPI PARANDALOI NJË PËRSHKALLËZIM TË MUNDSHËM NGA SERBIA NË KOSOVË NË ‘AVËT E FUNDIT’

FACE 5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar të premten me zëvendëssekretarin amerikan të shtetit, Christopher Landau, në Uashington, për t’i diskutuar fushat potenciale për bashkëpunimin ekonomik mes

dy vendeve në të ardhmen. Para këtij takimi Osmani ka mbajtur një ligjëratë në institut, përgjatë së cilës ka thënë se ka “informacione të besueshme” se presidenti amerikan Donald Trump ka parandaluar së voni

mundësinë e një përshkallëzimi të mundshëm të situatës nga Serbia në Kosovë. “Ai (Trumpi) është shumë i qartë në deklaratën e tij se po flet për javët e fundit”, ka thënë presidentja Osmani

**KUVENDI NUK
KONSTITUOHET AS NË
PËRPPJEKJEN E 45-t**

F. 7



**BEHRAMI: GJYKATA
SPECIALE, IMPIANT
I FABRIKIMIT TË
LËNDËVE GJYQËSORE**

F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



**PRISHTINA E RE ‘BLINDON’ MBROJTJEN
ME RUDOVIÇIN DHE PRENÇIN**

F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

30 vjet nga gjenocidi, boshnjakët nderojnë viktimat e Srebrenicës mes plagëve ende të hapura

SREBRENICË, 11 KORRIK - Mijëra boshnjakë janë mbledhur të premten në varrezat pranë Srebrenicës për ta përkujtuar 30-vjetorin e masakrës së vitit 1995, ku mbi 8 mijë burra dhe djem myslimanë boshnjakë ishin ekzekutuar nga forcat serbe të Bosnjës më 11-12 korrik 1995. Ky përkujtim shënon një nga krimet më të rënda në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore, ku rreth 1 000 viktima mbeten ende të pazbuluara, ndërsa shumë familje kanë zgjedhur të varrosin edhe vetëm disa kocka për t'u dhënë të afërmve një vend pushimi të denjë. Dihet se përgjegjësit kryesorë të masakrës, gjenerali Ratko Mlladiq dhe udhëheqësi politik serb Radovan Karaxhiq janë dënuar për gjenocid nga Tribunali i Kombeve të

Bashkuara në Hagë. "Reuters" ka raportuar se si pjesë e përkujtimit të këtij viti, rreth 7 000 persona kanë marrë pjesë në Marshin e Paqes, një udhëtim treditore prej 100 kilometrash në drejtim të kundërt të rrugës që ndoqën burrat boshnjakë për t'i shpëtuar vdekjes. Dy gjykata ndërkombëtare kanë vendosur se ngjarjet në Srebrenicë përbëjnë gjenocid, por udhëheqësit serbë në Bosnjë dhe në Serbi ende kundërshtojnë këtë term, numrin e viktimave dhe versionin zyrtar të ngjarjeve. Kujtojmë se edhe ky mohim vazhdon t'i ushqejë ndarjet politike dhe pengon integrimin e Bosnjës drejt Bashkimit Evropian. Vitin e kaluar Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e ka shpallur 11 korrikun Ditë

Ndërkombëtare të Reflektimit dhe Përkujtimit të Gjenocidit të Srebrenicës, duke nxitur organizimin e përkujtimeve zyrtare në shumë vende të botës. "Kjo nuk mund të harrohet kurrë. Kush mund të thotë se kjo nuk ishte gjenocid? Vetëm dikush pa shpirt", ka thënë Sabaheta për "Reuters", një nga të mbijetuarat e masakrës. Kujtojmë se masakra e Srebrenicës, e njohur ndërkombëtarisht si akt gjenocidi, ndodhi në një zonë që ishte shpallur "zonë e sigurt" nga OKB-ja dhe ishte e mbrojtur nga një kontingjent holandez prej 370 trupash paqeruajtëse të cilët dështuan ta parandalonin masakrën. Edhe pse më pas, ShBA-ja dhe NATO kanë reaguar me sulme ajrore për ta frenuar më tej



përshkallëzimin e konfliktit, raporti i Human Rights Watch i vitit 1999 ka kritikuar vonesat dhe dështimet e forcave ndërkombëtare, duke vënë në pikëpyetje efektivitetin e

mbrojtjes humanitare perëndimore. Në shënimin e 30-vjetorit të gjenocidit në Srebrenicë ka marrë pjesë edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti.

Trumpi: Armët amerikane do të dërgohen në Ukrainë përmes NATO-s

UASHINGTON, 11 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë më 10 korrik se Shtetet e Bashkuara janë duke dërguar armë në Ukrainë përmes NATO-s, një javë pasi Pentagoni ka bërë me dije që do të ndalojë së dërguari disa armë në këtë shtet të goditur nga lufta e Rusisë. Trumpi ka thënë se do të bëjë një "deklarim të madh" për Rusinë më 14 korrik. Ai nuk ka dhënë më shumë hollësi në këtë aspekt, mirëpo ka folur për dërgimin e armëve. "Po i dërgojmë armë NATO-s, dhe NATO-ja po paguan për këto armë 100 për qind. Pra, çfarë po bëjmë është se armët që po nisen, po shkojnë në NATO, dhe më pas NATO-ja do t'i dorëzojë këto armë në Ukrainë dhe NATO-ja do të paguajë për këto armë", ka thënë Trumpi në një intervistë për transmetuesin amerikan "NBC".



Më herët gjatë javës, Trumpi ka thënë se do të kërkojë nisjen e disa armëve për mbrojtje për Ukrainën pas komenteve negative të disa anëtarëve të Kongresit rreth njoftimit të Pentagonit, më 2 korrik, që disa armë nuk do të dërgohen, pas shqetësimeve se rezervat amerikane kanë rënë në mënyrë të konsiderueshme. Trumpi duket se e ka përmbysur këtë vendim më 8 korrik, kur ka thënë se Shtetet e Bashkuara do

të dërgojnë armë për mbrojtje të Ukrainës teksa shtohen sulmet ruse. Ai, gjithashtu, është shprehur i zemëruar me presidentin rus, Vladimir Putin, duke thënë se po e shqyrton mundësinë e vendosjes së sanksioneve të reja ndaj Moskës. Trumpi ka thënë se është duke e studiuar propozimin e senatorëve Lindsey Graham dhe Richard Blumenthal për vendosjen e sanksioneve dhe tarifave ndaj shteteve që mbështesin luftën e Rusisë, dhe masa të tjera ndëshkuese për sistemin bankar të Rusisë. "Besoj se do të bëj një deklarim të madh për Rusinë të hënën", ka thënë Trumpi gjatë intervistës. Ndërsa presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka bërë thirrje aleatëve t'i përdorin "asetet ruse" për rindërtim të

Ukrainës dhe ka kërkuar më shumë armë, investime dhe prodhim të përbashkët të armëve për mbrojtje. Më 10 korrik, sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka thënë se ia ka përsëritur homologut rus, Sergei Lavrov, se Moska duhet të jetë më fleksibile. Dy diplomatët janë takuar në margjina të një samiti në Malajzi. "Na duhet një plan veprimi për të ecur përpara për zgjidhje të këtij konflikti", ka thënë Rubio, duke shtuar se administrata Trump është angazhuar me Senatin amerikan rreth asaj se si mund të duken sanksionet e reja ndaj Rusisë. "Patëm bisedë të singertë. Ishte e rëndësishme", ka thënë Rubio pas takimit në Kuala Lampur. Ministria e Jashtme ruse ka thënë se Rubio dhe Lavrovi kanë pasur "këmbim të singertë dhe

substancial të pikëpamjeve të tyre". Rubio ka thënë se njoftimi i Pentagonit për dërgimin e armëve në Ukrainë është keqkuptuar dhe që shumica e ndihmës amerikane nuk është ndalur kurrë për Ukrainën. Ai e ka pranuar që Ukraina ka nevojë për më shumë sisteme Patriot dhe që disa janë "të qasshme në shumë shtete në Evropë, por askush nuk dëshirojë t'i ndajë me ta", prandaj ka thënë se beson që situata do të ndryshojë. Ai ka thënë se Rusia i ka humbur 100 mijë ushtarë prej janarit, dhe që ata janë vrarë, nuk janë vetëm të plagosur. Ukraina, sipas tij, ka humbur më pak ushtarë përgjatë asaj periudhe. "Ndonëse shifra është më e vogël, megjithatë është e konsiderueshme", ka deklaruar Rubio. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Epoka e dronëve pa pilot, revolucioni i mbrojtjes amerikane

UASHINGTON, 11 KORRIK - Sekretari i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Pete Hegseth, ka njoftuar fillimin e një epoke të re në fushën e luftës me dronë pa pilot, duke e quajtur këtë periudhë "dominio pa pilot". Ky lajm shënon një ndryshim të madh në mënyrën se si forcat amerikane do ta përdorin teknologjinë e dronëve në operacionet e tyre. Nga tani e tutje oficerët amerikanë do ta kenë lirinë të blejnë dhe testojnë dronë pa

nevojën për burokraci të gjatë, dokumente apo miratime të shumta nga nivele të ndryshme. Kjo do t'i lehtësojë shumë procedurat dhe do ta përshpejtojë përdorimin e dronëve në terren. Një aspekt i veçantë i këtij plani është që edhe dronët e prodhuar me printer 3D janë të lejueshëm për përdorim. Kushti i vetëm është që këta dronë të jenë funksionalë dhe të mund të fluturojnë - edhe nëse për vetëm disa minuta. Ky koncept ndryshon shumë nga

modeli tradicional i pajisjeve ushtarake që kushtojnë shtrenjtë dhe kërkojnë mirëmbajtje intensive. Ideja bazë është që droni të mos shihet si një aeroplan luftarak i kushtueshëm dhe i komplikuar, por si një mjet i thjeshtë dhe i disponueshëm, pothuajse si një plumb në arsenalin ushtarak. Nëse humbet një dron gjatë një operacioni, nuk ka problem - thjesht shtyp një tjetër me printer 3D dhe vazhdo misionin. Sekretari i Mbrojtjes ka thënë se



ishte frymëzuar nga mënyra se si Ukraina, Izraeli dhe Irani po përdorin tashmë dronë të lirë

dhe të thjeshtë për ta ndryshuar mënyrën e luftimit. Këto vende kanë treguar se UAV-të (mjetet fluturuese pa pilot) mund të jenë një faktor kyç në luftërat moderne, duke ofruar avantazhe strategjike të mëdha në fushën e betejës. Ky zhvillim tregon një ndryshim të rëndësishëm në filozofinë ushtarake amerikane, që po kalon drejt përdorimit më fleksibël dhe më efikas të teknologjisë, duke u përshtatur me nevojat dhe sfidat e kohës moderne.

“BLLOKU I KEQ” S’FILLON E S’MBARON ME NAZIM BLLACËN!



Shkruan:
Rrustem MUSTAFA

Nuk mund të lejojmë që e vërteta të përkufizohet me kurthet e ndërtuara me vite nga mekanizmat ruso-serbë. Ata kanë ndërtuar çdo hap për të njollosur UÇK-në, udhëheqësit e saj dhe vetë themelet e lirisë sonë - duke kulmuar me krijimin e një gjykate të veçantë që shumë herë duket më shumë si instrument politik sesa drejtësi. Sot, e keqja

përpiqet të reduktohet, të ripaketohen dhe të rikthehet përmes figurave të kompromentuara si Nazim Bllaca - një individ që nuk mund dhe nuk guxon të përfaqësojë as të keqen tonë, e aq ngushtë dhe aq më pak të vërtetën, e vërteta është “blloku i keq” ruso serb. Për fat të keq, një pjesë e mediave tona ose janë të

zhytura në joprofesionalizëm, ose po bien në grackën e atij “blloku të keq” ruso-serb që kërkon të destabilizojë besimin në shtet, në sektorët e sigurisë dhe në institucionet e republikës. Vëllezër e motra, kujdes! Lufta hibride është reale. Ajo zhvillohet me lajme të rreme, me përmbysje të narrativës, dhe me sulme ndaj policisë, ushtrisë e drejtësisë

sonë – që janë themelet e sigurisë dhe rendit në Republikën e Kosovës. Të qëndrojmë bashkë, të vëmendshëm dhe në mbrojtje të shtetit tonë. Mos e reduktoni një strategji antishtet në një të marrë! Lufta hibride ka fytyrë më të thellë se një dëshmitar i rrejshëm! Rreziku s’quhet vetëm Bllaca, por “Blloku i Keq” që e lindi!

BEHRAMI: GJYKATA SPECIALE, IMPIANT I FABRIKIMIT TË LËNDËVE GJYQËSORE

PRISHTINË, 11 KORRIK - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Artan Behrami, ka kritikuar Gjykatën Speciale për shkelje të Kushtetutës së Kosovës dhe konventave evropiane në rastin e Salih Mustafës. Ai ka vlerësuar se shkeljet në këtë rast janë brutale dhe të frikshme. Behrami ka shkruar në “Facebook” se Gjykata Speciale është implant i fabrikimit të lëndëve gjyqësore. “Shkeljet e Kushtetutës së Kosovës dhe konventave evropiane në rastin e Salih Mustafës janë brutale, të frikshme, të paprecedentë për hetues, prokurorë dhe gjykatës perëndimorë. Gjykata Speciale me vendimin e Calit po e dëshmon që është vetëm një version i zbehtë i gjyqësisë së EULEX-it, për të cilën këto net kemi pasur mundësi me përcjellë si ka



funksionuar! Por, vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës nuk

kanë të bëjnë shumë me Calin”, ka shkruar ai, duke shtuar se kjo gjykatë po i shkel të gjitha parimet. “Sipas

kësaj gjykate, rregullat speciale të përcaktuara nga Gjykata Speciale zhbëjnë të gjitha parimet mbi të cilat ka

funksionuar deri më sot drejtësia ndërkombëtare. Nuk ka më asnjë vlerë ligji i aplikueshëm në kohën kur pretendohet krimi, nuk vlen asgjë ligji më i favorshëm, nuk vlejnjë asgjë konventat evropiane, nuk vlen asgjë Kushtetuta e Kosovës, sidomos në versionin shqip dhe anglisht, derisa i përdorshëm është vetëm versioni serbisht!”, ka shkruar Behrami. Sipas tij, kjo gjykatë po krijon një precedent të rrezikshëm. “Gjykata Speciale dëshiron të krijojë një precedent, ku krerët e UÇK-së, në rast se nuk lirohen, mund të dënohen më shumë sesa që lejon ligji i aplikueshëm, Kushtetuta, konventat evropiane etj. Me vendimin për Calin, Gjykata Speciale sytë i ka te krerët e UÇK-së. Me këtë precedent ata mund të dënohen shumëfish më shumë se Cali”, ka shkruar Behrami.

LV-ja: LIGJI PËR AMNISTI I VITIT 2013, I DËMSHËM. PDK-JA AKUZON PARTINË E KURTIT SE PO GËNJEN PËR KËTË LIGJ

PRISHTINË, 11 KORRIK - Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur një konferencë për medie në të cilën ka rikujtuar 12-vjetorin e miratimit të Ligjit për Amnisti nga Kuvendi i Kosovës, duke e cilësuar si një kompromis të dëmshëm dhe një gabim historik që ka rezultuar nga marrëveshja e vitit 2013 për normalizim me Serbinë. Deputetja e LV-së, Arbëreshë Kryeziu, ka thënë se Ligji për Amnisti kishte dalë si rezultat i marrëveshjes së arritur më 27 qershor 2013 ndërmjet Hashim Thaçit dhe Ivica Daçiçit dhe se ai kishte krijuar bazën për amnistimin e kriminelëve serbë. “Sot, më 11 korrik, bëhen 12 vjet prej kur Kuvendi, nën kundërshtimin e



LV-së, mori vendim të dëmshëm për ta mundësuar votimin e Ligjit për Amnisti, ligj ky që doli si kompromis nga negociatat me Serbinë, përkatësisht marrëveshja që u arrit më 27 qershor 2013, e

ashtuquajtur marrëveshja për normalizimin në mes të Kosovës dhe Serbisë, në atë kohë e negociuar nga Thaçi dhe Daçiç. Kjo marrëveshje që hidhte farën e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe,

me vete mori edhe obligimin që mundësoi amnistimin e kriminelëve serbë. Votimi i tij ishte një kompromis i dëmshëm dhe një gabim historik”, ka thënë Kryeziu. Ndërsa deputeti tjetër i LV-së, Artan Abrashi, e ka ndërlidhur miratimin e Ligjit për Amnisti me përvjetorin e masakrës së Srebrenicës, duke e quajtur votimin e tij një ironi tragjike. Ndaj këtij qëndrimi të LV-së ka reaguar deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda. Ai ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje po vazhdon të gënjejë publikisht lidhur me Ligjin për Amnistinë. “LV-ja po vazhdon të gënjejë publikisht lidhur me Ligjin nr. 04/L-209 për Amnistinë. Deputetja

Arbëreshë Kryeziu dhe deputeti Artan Abrashi, në emër të kësaj partie, kanë mashtruar opinionin duke thënë se me këtë ligj janë falur edhe veprat penale të vrasjes”, ka shkruar Gruda në “Facebook”, duke e quajtur tërësisht të pavërtetë këtë qëndrim të deputetëve të LV-së. “Kjo është tërësisht e pavërtetë. Neni 4 i ligjit e përcakton qartë se nga amnistia përjashtohen veprat penale që kanë rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me vdekje. Ky manipulim i përsëritur disa herë nga LV-ja është i lehtë për t’u demantuar, mjafton ta lexoni vetë nenin 4 të ligjit dhe do ta shihni të vërtetën”, ka shkruar Gruda.



OSMANI NË SHBA: TRUMPI PARANDALOI NJË PËRSHKALLËZIM TË MUNDSHËM NGA SERBIA NË KOSOVË NË “JAVËT E FUNDIT”

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar të premten me zëvendëssekretarin amerikan të shtetit, Christopher Landau, në Uashington, për t'i diskutuar fushat potenciale për bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve në të ardhmen. Para këtij takimi Osmani ka mbajtur një ligjëratë në institut, përgjatë së cilës ka thënë se ka “informacione të besueshme” se presidenti amerikan Donald Trump ka parandaluar së voni mundësinë e një përshkallëzimi të mundshëm të situatës nga Serbia në Kosovë. “Ai (Trumpi) është shumë i qartë në deklaratën e tij se po flet për javët e fundit”, ka thënë presidentja Osmani

EPOKA E RE**Lirim GECI**

UASHINGTON, 11 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar me zëvendëssekretarin amerikan të Shtetit, Christopher Landau, në Uashington, me të cilin ka diskutuar për fushat potenciale për bashkëpunimin ekonomik mes të dy vendeve në të ardhmen. Zëdhënësjja e Departamentit amerikan të Shtetit, Tammy Bruce, ka thënë se palët kanë shprehur bindje që “prosperiteti ekonomik dhe bashkëpunimi do t'i ndihmojnë Ballkanit Perëndimor që të largohet nga ndasitë e së kaluarës dhe të promovojë paqe të qëndrueshme dhe stabilitet në rajon”. Osmani ka thënë në “Facebook” se “Kosova qëndron krah për krah me Shtetet e Bashkuara

për të ndërtuar kapituj të rinj të bashkëpunimit strategjik në përputhje me vizionin e fortë të presidentit Trump”.

Më 9 korrik Osmani është takuar edhe me zyrtarin e lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit për Çështje Evropiane, Brendan Hanrahan, i cili pritet ta vizitojë Kosovën në ditët në

vijim. Osmani ka thënë se bashkë me diplomatin amerikan kanë diskutuar për “thellimin e partneritetit strategjik midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara”.

“Kosova është e gatshme ta avancojë bashkëpunimin me ShBA-në në fusha kyçe si mbrojtja, ekonomia si dhe

investimet strategjike me interes të ndërsjellë”, ka thënë Osmani.

Në kuadër të vizitës së saj në Uashington, Osmani ka mbajtur edhe një ligjëratë në Hudson Institute në Uashington D.C., përgjatë së cilës ka thënë se ka “informacione të besueshme” se presidenti amerikan Donald Trump ka parandaluar së voni mundësinë e një përshkallëzimi të mundshëm të situatës nga Serbia në Kosovë.

“Ai (Trump) është shumë i qartë në deklaratën e tij se po flet për javët e fundit”, ka thënë presidentja Osmani, duke theksuar se nuk bëhet fjalë për zhvillime të vitit 2023 apo 2020,

por “për zhvillime shumë, shumë të vona. Ndaj, nuk duhet ta mohojmë mundësinë, sepse ka ndodhur më parë”, ka thënë Osmani, duke iu referuar sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit më 2023, kur një grup serbësh patën sulmuar Policinë e Kosovës, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Në fjalën e saj, presidentja Osmani ka paralajmëruar se rreziqet nga Serbia janë të vazhdueshme dhe se ato nuk duhen nënvlerësuar. Sipas saj, presidenti Trump ka bërë gjithçka që është në fuqinë e tij deri tani për ta siguruar ruajtjen e paqes në gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke folur për takimet që po zhvillon në Amerikë dhe



KUVENDI NUK KONSTITUOHET AS NË PËRPPJEKJEN E 45-t

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në përpjekjen e 45-të, meqë partitë politike vazhdojnë të ngulmojnë se kanë të drejtë në qëndrimet e veta. Në seancën e 11 korrikut kanë marrë pjesë 93 deputetë.

Abelard Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës e ka akuzuar kryesuesin e seancës, Avni Dehari - nga Lëvizja Vetëvendosje - për shkelje të Kushtetutës. “Kjo është e papranueshme”, ka thënë Tahiri nga foltorja e Kuvendit, teksa Dehari ka kërkuar që atij t’i ndalet mikrofonin. Akuza kundër Deharit kanë pasur edhe përfaqësues të partive të tjera, të cilëve, gjithashtu u është ndaluar mikrofonin.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e

Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë nuk janë duke pranuar të propozojnë nga një kandidat për formim të një komisioni për votim të fshehtë, me arsyetimin se mënyra e ndryshimit të votimit është jokushtetuese.

Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje, fituese e më së shumti votave në zgjedhjet e 9 shkurtit, është duke kërkuar që për Albulena Haxhiun, të propozuar për kryeparlamentare, të votohet vetëm një herë përmes votimit të fshehtë dhe nëse nuk i siguron 61 votat e nevojshme, ajo do të tërhiqet nga gara. Ajo nuk i ka siguruar votat e nevojshme në disa seanca radhazi që janë mbajtur me



votim të hapur. Për disa parti ajo është figurë përçarëse dhe e papranueshme. Pjesëtarë të shoqërisë civile kanë protestuar sërish para

ndërtesës së Kuvendit duke i thirrur deputetët në përgjegjësi. Ata janë parë duke mbajtur në duart pankarta me mbishkrimet: “Demokracia

nuk është veç procedurë”, “Cirku i Republikës së Kosovës”, “120 rroga, 0 përgjegjësi” e tjera.

Palët vazhdojnë të mos gjejnë një kompromis ndonëse ecën afati i përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për konstituim të Kuvendit. Ndonëse gjykata e ka përcaktuar 26 korrikun afat të fundit për konstituim, ajo nuk ka ofruar më shumë hollësi se çfarë ndodh tutje nëse partitë nuk merren vesh deri atëherë. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar me përfaqësuesit e partive politike ditë më parë, me shpresën e gjetjes së një zgjidhjeje, mirëpo situata nuk ka ndryshuar. Ajo e ka përmendur edhe mundësinë që t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për sqarime shtesë.



marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, Osmani ka thënë se administrata e presidentit Trump ka ide të reja për t’i forcuar më tej ato. “Ne duam të ulemi me partnerët në këtë administratë për t’u shpjeguar se si Kosova ka këtë potencial. Kjo, natyrisht, është në interes të popullit tonë, në interes të vendit tonë dhe në interes të rajonit tonë. Por, në të njëjtën kohë, kjo përputhet me prioritetet e administratës

Trump për ta bërë Amerikën më të sigurt, më të fortë dhe më të begatë”, ka thënë Osmani. Sipas saj, në takime me zyrtarët amerikanë nuk është diskutuar për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë - “për herë të parë pas shumë vitesh”.

“Kemi folur për Kosovën dhe Shtetet e Bashkuara. Për herë të parë nuk kemi folur për Serbinë. Perfekt. Ishin biseda perfekte”, ka deklaruar Osmani

pa hyrë në shumë detaje. Kujtojmë se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka përmendur disa herë ndërmjetësimin e tij në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë si shembull i rolit të ShBA-së në parandalimin e konflikteve.

Dy vendet gjatë mandatit të parë të Trumpit kanë nënshkruar një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në

Osmani takohet me senatorin Andy Kim: Bisedojnë për forcimin e partneritetit Kosovë - ShBA

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të vizitës në ShBA është takuar me senatorin Andy Kim. Osmani ka thënë se të dy kanë diskutuar për forcimin e partneritetit strategjik midis Kosovës dhe Amerikës në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët, përfshirë sigurinë, zhvillimin ekonomik dhe inovacionin. “Kosova është e bekuar me mbështetjen e fuqishme dhe

të palëkundur të Kongresit Amerikan! Në Uashington D.C. kisha kënaqësinë ta takoj senatorin Andy Kim, për të diskutuar për forcimin e partneritetit strategjik midis Kosovës dhe Amerikës në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët, përfshirë sigurinë, zhvillimin ekonomik dhe inovacionin”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.

praninë e tij në vitin 2020. Megjithatë, marrëveshja, e cila përfshinte edhe njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Izraeli, nuk është zbatuar kurrë në tërësi.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pati thënë se “nuk di” gjë për një zhvillim të tillë. Kurti në “Tëvël” kishte thënë se nuk ka informacione dhe se s’i di planet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. “Është vështirë të them sepse nuk mund t’i di planet që i kanë, s’i kam as informacionet e tyre, me siguri Shtëpia e Bardhë ka më shumë informacion se çfarë synimesh ka pasur Serbia

dhe mund të kenë vepruar kundër tyre, faleminderit shumë! Por ato informacione që kanë ata se çfarë ka bërë si plan konkret kundër Kosovës, ne nuk e dimë. Organet tona bashkëpunojnë me ShBA-në, mbase një ditë do t’i kemi ato informacione, por aktualisht nuk i kemi ato”, kishte thënë Kurti.

Shtetet e Bashkuara kanë ndarë mbi dy miliardë dollarë për Kosovën prej vitit 1998. Udhëheqës shtetërorë kosovarë e përsërisin shpesh që Amerika është partnerja më e rëndësishme e Kosovës dhe se mbështetja e saj është jetike.

Limaj: Do ta ftoj Kurtin për kafe javën e ardhshme

PRISHTINË, 11 KORRIK - Pas dështimit të 45-të me radhë për konstituimin e Kuvendit të Kosovës, kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka deklaruar se do t’i vazhdojnë përpjekjet për të gjetur një zgjidhje për ngërçin politik dhe ka paralajmëruar një takim të mundshëm me

kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, javën e ardhshme. “Do të vazhdojmë të kemi takime. Kryeministri, nëse nuk gabo, është në Bosnjë. E kam ndër mend ta ftoj për kafe, që të gjejmë zgjidhje. Sot kthehet dhe mendoj javën e ardhshme do ta ftoj”, ka thënë Limaj, duke shtuar se palët politike tashmë

kanë bërë lëshime nga pozicionet e tyre fillestare. “Ne shumë kemi lëvizur shumë nga pozicioni. Krejt i kemi ofruar mundësitë tona”, ka thënë ai. Limaj ka theksuar se zgjidhja përfundimtare e krizës duhet të fokusohet në interesin shtetëror dhe në

funksionalizimin e institucioneve demokratike. “Kam përshtypjen që ky ngërç përfundimisht duhet të kalohet duke vendosur në epiqendër shtetin. Shtetin çdo ditë duhet ta meritojmë e ta mirëmbajmë për ta pasur, nuk është diçka e mirëqenë”, ka thënë Limaj.



Sami Lushtaku kandidon për kryetar të Skenderajt

SKENDERAJ, 11 KORRIK - Sami Lushtaku ka bërë me dije se do të jetë kandidat i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Skenderajt. Ai ka thënë se kandidatura është përkrahur edhe nga kryesia e degës në këtë komunë. “Kandidatura ime vjen edhe si rezultat i padrejtësive ndaj meje në të kaluarën, përfshirë mbajtjen e katër vjet e gjysmë burgim gjatë viteve 2013-2017, proces nga i cili në fund jam shpallur i pafajshëm, si dhe më

pas, moslejimi i kandidaturës sime në zgjedhjet lokale të vitit 2021 nga KQZ, për shkak të presioneve politike nga eksponentë të pushtetit aktual i cili tashmë është në shkuarje”, ka thënë Lushtaku. Më tutje Lushtaku ka thënë se kandidimi i tij është thirrje për bashkim, për zhvillim, për drejtësi dhe për dinjitetin e Skenderajt. “Skenderaj do të bëhet çdo vit më i zhvilluar, me punë, me projekte dhe me udhëheqje të drejtë për të gjithë, kurse programin e plotë do

ta paraqesë gjatë javëve të ardhshme”, ka thënë Lushtaku, i cili ka falënderuar kryetarin aktual, Fadil Nura. “Një falënderim i veçantë shkon për kryetarin aktual të komunës, Fadil Nura, për punën dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë kësaj periudhe. Duke qenë mirënjohës përjetë për besimin dhe mbështetjen tuaj ndaj meje dhe ndaj Partisë Demokratike të Kosovës, do të jemi bashkë si gjithmonë në çdo proces”, ka thënë Lushtaku.



DIPLOMON GJENERATA E 62-të E POLICISË

VUSHTRRI, 11 KORRIK - Të premtën është mbajtur ceremonia e diplomimit të gjeneratës së 62-të të kadetëve të Policisë së Kosovës. Në këtë ceremoni ka marrë pjesë zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi. Në adresimin e tij ai ka thënë se për 26 vjet me radhë që nga krijimi, Policia e Kosovës shërben me përkushtim e integritet. “Ky institucion po forcohet e radhët e saj po shtohen çdoherë e më shumë. 62 gjenerata të diplomuara, përfshirë këtë të sotmen, të cilat udhëhiqen nga profesionalizmi, në mbrojtje të Republikës, ligjeve e Kushtetutës së vendit, sovranitetit e integritetit territorial. Të jesh pjesë e Policisë së Kosovës është nder dhe përgjegjësi e lartë. Kjo uniformë dhe ky institucion është më shumë sesa zbatuese e ligjit, por edhe përfaqësuese e vlerave të disiplinës ndaj punës, integritetit dhe atdhedashurisë”, ka thënë Bislimi. Ai ka theksuar se kadetët e policisë i përbashkon misioni e qëllimet e njëjta, ndërsa në realizimin e tyre do ta kenë përherë qeverinë përkrah. “Përgjatë mandatit e kemi rritur mbi 50 për qind buxhetin për Policinë e Kosovës në krahasim me vitin 2021: nga rreth 90 milionë, në tash më shumë se 150 milionë. Kemi investuar edhe në



pajisje policore logjistike e automjete si dhe ngritur e rregulluar stacione të policisë, përfshirë edhe në veriun e vendit. Mbështetjen institucionale të munguar e kemi kthyer në vëmendje të merituar ndaj policisë dhe përkrahje të domosdoshme e të parrezervë”, ka thënë Bislimi, duke shtuar se besimi i lartë i qytetarëve ndaj Policisë së Kosovës sjell edhe më shumë përgjegjësi e obligim për

secilin prej tyre. “Andaj prej jush kërkohet të jeni vazhdimisht syçelë, të disiplinuar dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrave me të cilat do të ngarkoheni tash e tutje. Përpjekjet dhe fushatat për ta cenuar integritetin, profesionalizmin dhe imazhin e Policisë së Kosovës bazuar në raste të izoluara, tregojnë për qëllime në dëm të interesave të Republikës së Kosovës e kërcënim ndaj

institucioneve të saj të respektuara si policia”, ka thënë Bislimi. Në përfundim të fjalës së tij ai ka thënë se “ndershmëria, përgjegjësia, integriteti profesional e personal, le ta udhëheqin rrugëtimin tuaj për sa kohë do ta mbani të veshur këtë uniformë, duke u frymëzuar edhe në jetën e kontributin e heronjve të Policisë së Kosovës si Enver Zymberi, Afrim Bunjaku dhe të gjithë të

rënëve në krye të detyrës”. Ndërsa ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se kjo gjenerata e re e Policisë së Kosovës është mbështetja e vizionit tonë të përbashkët për një polici profesionale që garanton rend e ligj, që respekton e mbron qytetarët tanë dhe që me integritet e disiplinë mbron besimin e qytetarëve të ndërtuar ndër vite për policinë.

LDK-ja nominon kandidatët për kryetarë të komunave, asnjë grua në mesin e tyre

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në mbledhjen e saj të rregullt, të udhëhequr nga kryetari Lumir Abdixhiku, ka ka miratuar kandidaturat për kryetarë të komunave për zgjedhjet e ardhshme lokale. Kandidatët e nominuar janë: Përparim Rama (Prishtinë), Imri Ahmeti (Lipjan), Xhafer Gashi (Obiliq), Besnik Osmani (Fushë-Kosovë), Ekrem Hyseni (Podujevë), Gazmend Heta (Drenas), Xhafer Tahiri (Vushtrri), Gëzim Plakolli (Mitrovicë), Gazmend Muhaxheri (Pejë), Ilir Ferati (Istog), Ruzhdi Shehu (Junik),

Jeton Mushkolaj (Deçan), Bexhet Xheladini (Dragash), Driton Selmanaj (Prizren), Ardian Shala (Suharekë), Visar Azemi (Ferizaj), Kastriot Shabani (Shtime), Valmir Ahmeti (Shtërpçë), Sokol Haliti (Viti), Arbër Ismajli (Gjilan), Bajrush Ymeri (Artanë), Shefqet Shehu (Gjakovë), Burim Krasniqi (Rahovec). “Këta janë njerëzit tanë, janë kandidatët më të mirë, më të zotit dhe ata që u njohin brengat qytetarëve. Në frymë të bashkëpunimit, unitetit dhe përkushtimit të plotë, LDK po hyn në këtë proces zgjedhor me vizion të qartë dhe me ekipe të

përgatitura në çdo degë. Fryma pozitive dhe mobilizimi i strukturave po dëshmojnë gatishmërinë e LDK-së për t’u rikthyer fuqishëm në shërbim të qytetarëve në nivel lokal, ndërsa në komunat ku udhëheqim të vazhdoj shërbimi i drejtë dhe transparent ndaj qytetarëve. Degët e LDK-së janë duke bërë përgatitjet e fundit për një fushatë të dinjitetshme, konstruktive dhe të orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve. LDK-ja në të gjitha komunat do të jetë me zgjidhje konkrete, njerëz të dëshmuar dhe vullnet të palëkundur për



zhvillim të komunës”, ka njoftuar LDK-ja. Në mesin e kandidatëve të

LDK-së për kryetarë të komunave nuk është asnjë grua.

Kadrijaj e AAK-së: Kurti është strumbullari i korrupsionit dhe keqpërdorimeve

PRISHTINË, 11 KORRIK - Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, ka folur të premten për skandalet e qeverisë Kurti. Ajo në Kuvendin e Kosovës ka thënë se deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje janë të frustruar pasi, sipas Albin Kurtit, ka ardhur në pushtet për luftimin e korrupsionit, ndërsa sot është duke e bërë të kundërtën. “Albin Kurti ka ardhur në pushtet me premtime të

mëdha, një prej premtimeve që ka marrë më së shumti mbështetje ka qenë se do t'i luftonte oligarkët, ndërsa sot çfarë po bën kjo qeveri dhe kjo parti? A është oligark Martin Berishaj? Ambasadori i Kosovës në Kroaci, i akuzuar së fundmi nga zyra e prokurorit në Slloveni, për veprën penale ‘keqpërdorim i pozitës nga një zyrtar; dhe abuzimi me miliona euro. A kemi pasur kritikë dhe shkarkim të këtij drejtori? Jo,

s’kemi pasur, sepse është shok i Albin Kurtit dhe jo që s’është sulmuar, por është mbrojtur”, ka thënë Kadrijaj. Kadrijaj ka përmendur edhe, siç i quan ajo, skandalet e Nagip Krasniqit, Dejhona Mihalit, Ridvan Muharremit, Rozeta Hajdarit dhe Driton Dalipit. “Albin Kurti është strumbullari i korrupsionit dhe i keqpërdorimeve bashkë me kabinetin e tij qeveritar”, ka thënë Kadrijaj.



PROKURORIA PO HETON KONTRATËN PËR NDËRTIMIN E URAVE TË REJA NË MITROVICË

PRISHTINË, 11 KORRIK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka njoftuar se e ka nisur një hetim në lidhje me ligjshmërinë e kontratës për ndërtimin e dy urave të reja mbi lumin Ibër në Mitrovicë nga Qeveria në detyrë e Kosovës. Në një njoftim për medie, PSRK-ja ka treguar se hetimi nuk ka të bëjë me ndonjë kundërshtim ndaj ndërtimit të urave në fjalë, por me “përmbushjen e detyrimeve ligjore” të kontratës për ndërtimin e tyre. Ajo ka thënë se, derisa nuk është në detyrën e saj të vlerësojë apo të aprovojë ndonjë projekt infrastrukturor, “roli i Prokurorisë Speciale është të veprojë bazuar në ligjet në fuqi, në rastet kur ekzistojnë dyshime për keqpërdorim të fondeve publike”. “Prokuroria Speciale njofton opinionin publik se nuk e ka në kompetencë të vlerësojë apo të aprovojë ndonjë projekt infrastrukturor, por theksojmë se roli i PS-së është të veprojë bazuar në ligjet në fuqi, në rastet kur ekzistojnë dyshime për keqpërdorim të fondeve publike. Prokuroria Speciale, nëpërmjet pesë prokurorëve të angazhuar, i ka aktualisht në trajtim afër dy mijë kontrata njëburimore”, ka njoftuar PSRK-ja. Pesë prokurorë janë angazhuar për t’i hetuar dy mijë kontrata burimore, përfshirë atë për ndërtimin e urave në Mitrovicë, sipas PSRK-së. “Bazuar në këtë, Prokuroria Speciale ka autorizuar Policinë e Kosovës t’i ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore me qëllim të konstatimit të drejtë

të gjendjes faktike për të gjitha dyshimet lidhur me rastin, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Hetimi për kontratën për ndërtimin e urave në Mitrovicë nuk ka të bëjë me ndonjë kundërshtim ndaj projektit në fjalë, por me përmbushjen e obligimeve ligjore, në mbrojtje të interesit publik dhe sundimit të ligjit, në mënyrë që të garantohet një administrim i drejtë dhe ligjor i resurseve publike”, ka njoftuar PSRK-ja. Ndaj këtij zhvillimi brenda PSRK-së ka pasur reageime të shumta sidomos nga përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje. Deputeti i LV-së, Artan Abrashi, në një konferencë për medie, ka thënë se veprimet e deritashme të Prokurorisë Speciale janë për keqardhje dhe se në vend të luftimit të krimit të organizuar, po vihen në funksion të sulmit ndaj institucioneve të Kosovës. “Sa i përket pyetjes për Prokurorinë Speciale është për keqardhje që prokuroria, në vend se ta kryejë obligimin dhe mandatin e saj kushtetues në luftimin e krimit të organizuar, është vu në funksion të luftimit të institucioneve të Kosovës. Fakti që dikush heton kontrata të cilat lidhen me angazhimin e Qeverisë së Kosovës për të shtruar sovranitet, ligj, për ta përmirësuar lirinë e lëvizjes së qytetarëve, për ta shtrirë rendin dhe ligjin, pra ndërtimin e urave dhe i shëh si rrezik, e shkelje të ligjit, nuk kam fjalë tjetër pos të shpreh millef”, ka thënë Abrashi.



Gurthemeli për fillimin e ndërtimit të këtyre dy urave në të dy krahët e urës kryesore mbi lumin Ibër përmes të cilave qeveria në detyrë ka thënë se synon ta lidhë Mitrovicën e Veriut të banuar me shumicë serbe me Mitrovicën e Jugut të banuar me shumicë shqiptare u vendos në fillim të korrikut në prani të kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti. Ndërtimi i këtyre dy urave të reja - njëra për automjete dhe tjetra për këmbësorë - pritet të përfundojë në vjeshtë dhe kostoja e tyre kap shifrën e rreth 3 milionë eurove, sipas zyrtarëve. Qeveria në detyrë e Kosovës ka thënë se projekti i ndërtimit të urave është iniciuar me kërkesë

të dy komunave si rezultat i krijimit të Bordit të Përbashkët të Mitrovicës. Por, qëllimi i saj për ndërtimin e këtyre urave u kundërshtua nga serbë lokalë, të cilët e shohin këtë veprim si “provokim politik” dhe jo si mjet për lidhjen e komuniteteve. Një peticion kundër urave, i nisur nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë që gëzon përkrahjen e Beogradit, ka mbledhur mbi 3 000 nënshkrime, sipas kësaj partie. Bashkimi Evropian ka deklaruar se ndërtimi i dy urave të reja mbi lumin Ibër “ka rëndësi praktike dhe politike”, dhe se çdo projekt infrastrukturor midis Mitrovicës së Veriut dhe asaj të Jugut kërkon bashkërendim të ngushtë dhe

dialog mes të gjitha komuniteteve të përfshira.

“Është e domosdoshme që këto projekte ta pasqyrojnë vullnetin dhe nevojat e komuniteteve lokale”, kanë thënë nga BE-ja.

Urat e reja po ndërtohen pranë urës kryesore mbi Ibër, e cila është pjesë e Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes të arritur në dialogun Kosovë - Serbi. Kjo urë është e njohur për përplasjet etnike pas luftës dhe për këtë arsye është nën mbikëqyrjen e forcave të KFOR-it.

Ura është e hapur vetëm për këmbësorë, ndërsa Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar hapjen e saj edhe për automjete në korrik të vitit të kaluar, gjë që pati shkaktuar tensione dhe reageime nga bashkësia ndërkombëtare.

Kosova dhe Serbia ishin pajtuar që ura të hapej për qarkullim në vitin 2014 në dialogun për normalizim të marrëdhënieve. Ishte paraparë revitalizimi i urës dhe largimi i të gjitha barrikadave të vendosura nga serbët lokalë.

Në vitin 2016 ishte arritur pajtueshmëri për një plan të ri zbatimi për t’i tejkaluar mosmarrëveshjet rreth interpretimeve të marrëveshjeve të mëparshme. Sipas këtij plani, ura duhej të hapej për automjete në janar të vitit 2017.

Punimet për revitalizim e urës kanë përfunduar në qershor të vitit 2018, ndërsa ura - në të cilën janë investuar 1.5 milion euro - nuk është hapur kurrë për automjete, por vetëm për këmbësorë.

Mbyllen përkohësisht 30 qendra mesazhi dhe klube nate në të gjithë Kosovën

PRISHTINË, 11 KORRIK - Autoritetet e Kosovës kanë mbyllur përkohësisht 30 qendra mesazhi dhe klube nate gjatë një operacioni të gjerë në mbi 100 operatorë ekonomikë në të gjithë Kosovën. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës (MINT) ka njoftuar në një komunikatë të premten se inspektorët e saj, në bashkëpunim me policinë, Administratën Tatimore dhe institucione të tjera u

inspektuan 114 subjekte ekonomike të cilat ushtrojnë veprimtari tregtare dhe aktivitete argëtimi. “Kjo mbyllje është për shkak të mosregjistrimit të bizneseve si dhe mungesës së pëlqimit/aktvendimit për plotësimin e kushteve minimale teknike”, ka njoftuar MINT-i. Kjo ministri ka theksuar se ka shqiptuar 33 masa ndëshkuese ndaj operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë e

tyre në kundërshtim me ligjin, pa treguar se çfarë masash saktësisht. Aksioni i përbashkët ka rezultuar me inspektimin e 114 subjekteve ekonomike, përkatësisht 67 operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari tregtare - aktivitete të mirëmbajtjes trupore (qendra mesazhi), 47 operatorë ekonomikë që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe aktivitete të tjera të argëtimit si muzikë nate.



ASK-ja: ÇMIMI I RRYMËS ËSHTË SHTRENJTUAR 17.8 PËR QIND

PRISHTINË, 11 KORRIK - Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK) është më i lartë në një mesatare prej 4.3-përqindësh në muajin qershor 2025, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), vetëm energjia elektrike është shtrenjtuar 17.8 për qind në qershor 2025 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Ndërsa sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni mujor ishte 0,7 për qind në muajin qershor 2025. “Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4.3-përqindësh në muajin qershor 2025 krahasuar me muajin qershor 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafe,

çaj dhe kakao 18.2 për qind; energji elektrike 17.8 për qind; pemë 14.8 për qind; pushime të organizuara 13.3 për qind; mish 12.8 për qind; shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (10.4 për qind); vajra dhe yndyra (9.7 për qind); shërbime hoteliere (7.7 për qind); perime (7.2 për qind); shërbime ambulatore (7.1 për qind); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (6.7 për qind); gazeta, libra dhe materiale për zyra (6.4 për qind); pije alkoolike (6.4 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (5.7 për qind); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (5.4 për qind); shërbime financiare (5.2 për qind); kujdes personal (4.9 për qind); bukë dhe drithëra (4.8 për qind); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (4.8 për qind); këpucë (4.2 për qind); prodhime ushqimore (4.1 për



qind); mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (3.9 për qind); furnizim me ujë dhe shërbime të ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (3.5 për qind); duhan (3.4 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (3.1 për qind) dhe gjëra personale (2.7 për qind)”, ka njoftuar ASK-ja. Më tutje, ASK-ja ka njoftuar se

rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal 5.3 për qind, lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. 4.5 për qind dhe bileta të fluturimeve 3.2 për qind, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.5-përqindësh në IHÇK.

ASK-ja ka theksuar se indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0.7-përqindësh në muajin qershor 2025 krahasuar me muajin maj 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pushime të organizuara 10.4 për qind; energji elektrike 5.4 për qind, pemë 5.1 për qind, kafe, çaj dhe kakao 2.3 për qind, karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal 2.1 për qind; pije alkoolike 1.7 për qind, mish 1.4 për qind, shërbime hoteliere 1 për qind, bukë dhe drithëra 1 për qind, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.9-përqindësh në IHÇK. Kurse sipas ASK-së, rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: perime 5.6 për qind me një ndikim prej 0.2-përqindësh në IHÇK.

VENDIMI I KUSHTETUESES: NJIHET E DREJTA E PENSIONIT PËR PUNËTORËT E LARGUAR GJATË VITEVE '89-'99

PRISHTINË, 11 KORRIK - Gjykata Kushtetuese ka publikuar aktgjykimin në rastin KO35/24, të iniciuar nga Avokati i Popullit, i cili kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-248 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Gjykata me vendim unanim ka konstatuar se neni 4 i Ligjit të Kontestuar, i cili shton nenin 8A në Ligjin bazik, nuk është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës (Barazia para Ligjit), si dhe me nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të



kësaj Konvente.

Përmes këtij aktgjykimi Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se

ligjvënësi ka respektuar gjetjet e mëparshme të gjykatës në rastin KO190/19, duke eliminuar

diskriminimin e mëhershëm ndaj punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, policisë, gjyqësorit dhe të tjerëve, të cilët ishin përjashtuar nga e drejta për pension kontributpagues të moshës.

Me ndryshimet ligjore është krijuar një skemë e re pensionale, “pension parcial kontributpagues i moshës”, që ua njeh të drejtën në pension të gjithë punëtorëve të dëbuar nga puna gjatë viteve 1989-1999 si pasojë e masave të dhunshme, edhe në rastet kur nuk arrijnë stazhin e plotë prej 15 vitesh.

Gjykata ka thekuar se nuk kërkohet më dëshmi për pagesë

të kontributeve për vitet 1989-1999, por vetëm dëshmi që punëtori është larguar nga puna gjatë kësaj periudhe.

Në këtë mënyrë është eliminuar pabarazia ndërmjet grupeve të punëtorëve, duke siguruar trajtim të barabartë dhe gjithëpërfshirës në të drejtën për pension.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ligji i kontestuar garanton një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave themelore të individëve, duke përbushur standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për ndalimin e diskriminimit.

Punëtorët e sigurimit në QKUK hyjnë në grevë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Punëtorët e sigurimit fizik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), të mbështetur nga Federata Sindikale e Punëtorëve Teknikë të Sektorit Privat të Kosovës, kanë hyrë në grevë për shkak të moszgjidhjes së çështjes së punësimit të punëtorëve të sigurimit fizik në QKUK. Greva do të vazhdojë çdo ditë prej orës 10:00 deri në orën 15:00, derisa të plotësohen kërkesat e punëtorëve.

Kryetari i Federatës Sindikale të

Punëtorëve Teknikë të Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka thënë se moszgjidhja e kësaj çështje ka tejkaluar çdo limit. “Për dy javë nuk kemi lënë derë pa hapur që ta zgjidhim problemin dhe ta shkurtrojmë afatin e këtyre punëtorëve që të qëndrojnë jashtë procesit të punës. Përkundër asaj kemi hulumtuar në KRPP e OShP dhe na është thënë se QKUK-ja i ka të gjitha dyert e hapura dhe duart e lira të vendosë për tenderin. Kemi informacione

zyrtare nga të gjithë, edhe OShP-ja, edhe KRPP-ja që ky tender mund të zgjatë maksimumi tri ditë dhe nëse është vullneti dhe dëshira e QKUK-së mund të përfundojë brenda tri orëve”, ka thënë Azemi.

Ndërsa përfaqësuesi i Shoqatës së Sigurimit Fizik të QKUK-së, Hakif Sylejmani, ka kërkuar sqarim institucional dhe vendim të qartë për fatin e tyre. “Ne jemi në halle shumë të mëdha si punëtorë në QKUK



dhe kemi shumë padrejtësi brenda institucionit të QKUK-së. Këtu është çështja e këtyre

tenderëve, çështja e rikthimit në menaxhim të brendshëm”, ka thënë Sylejmani.

FRANCA DHE BRITANIA E MADHE FIRMOSIN MBROJTJEN BËRTHAMORE TË EVROPËS. SHBA: NGA RUSIA, NJË IDE PËR TRUMPIN



Nga Luigi IPPOLITO,
Corriere della Sera

Macron dhe Starmer kanë arritur një marrëveshje: dy vendet e armatosura me armë bërthamore në Evropë do të garantojnë një "ombrellë bërthamore" dhe një forcë të përbashkët prej 50,000 trupash. Debutimi i SHBA-së me "Willing". Takimi Rusi-Shtetet e Bashkuara. Ombrella bërthamore franko-britanike e vendosur për të mbrojtur Evropën: ky është rezultati më domethënës i samitit të Londrës midis Keir Starmer dhe Emmanuel Macron, një marrëveshje që Kryeministri Laburist e quajti "një moment historik për botën". "Ne jemi dy kombet bërthamore në Evropë", tha Starmer në konferencën për shtyp, "dhe kemi rënë dakord të bëjmë një hap të jashtëzakonshëm përpara në mënyrën se si i koordinojmë aftësitë tona për të

mbështetur Evropën dhe NATO-n."

Macron: "Çdo kërcënim ekstrem do të përballlet me një përgjigje të shpejtë"

Siç shpjegoi Macron, Britania e Madhe dhe Franca kanë modifikuar doktrinën e tyre bërthamore, dhe që tani e tutje, çdo "kërcënim ekstrem" ndaj Evropës do të përballlet me një "përgjigje të shpejtë" nga të dy kombet: "Një mesazh që partnerët tanë, si dhe kundërshtarët tanë, duhet ta marrin parasysh", paralajmëroi presidenti francez. Dy forcat kombëtare bërthamore mbeten të pavarura, por që tani e tutje do të jenë "të koordinuara".

Qëndrimi i paqartë i Trump mbi Nenin 5 të NATO-s

Në praktikë, Londra dhe Parisi

po marrin përgjegjësinë për mbrojtjen e Evropës përballë paqartësive të Donald Trump në Amerikë, e cila ka shkuar aq larg sa të vërë në dyshim angazhimin e tij ndaj Nenit 5 të NATO-s, i cili kërkon një përgjigje kolektive ndaj agresionit kundër një shteti anëtar. Tani, britanikët dhe francezët po e marrin përsipër këtë angazhim drejtpërdrejt sepse, siç tha Macron, të dy kombet ndajnë një "përgjegjësi të veçantë" për sigurinë e kontinentit, si të vetmet fuqi bërthamore me forca të armatosura të besueshme. Mbrojtja e përbashkët evropiane do të sigurohet edhe në frontin konvencional, me ndërtimin e përbashkët të raketave anti-anije të gjeneratës së ardhshme dhe një gamë të tërë armësh të përparuara, duke përfshirë ato të bazuara në inteligjencën artificiale. Dhe mbi të gjitha, me zgjerimin e forcës franko-britanike të reagimit të shpejtë

në 50,000 burra, e cila po rifokusohet në mbrojtjen e Evropës dhe po bëhet "e gatshme për luftime". Sipas Elizesë, ajo mund të shërbejë si "një bërthamë për planifikimin e forcave të sigurisë që do të vendosen potencialisht në Ukrainë si pjesë e një armëpushimi të ardhshëm".

Ukrainës paqen dhe prosperitetin që meriton."

Megjithatë, përballë ngurrimit amerikan për t'u angazhuar për një garanci sigurie për një forcë të mundshme paqeruajtëse të dërguar në Ukrainë, koalicioni është ripërqendruar në vendosjen e Kievit në pozicionin më të mirë të mundshëm për një armëpushim: trajnimin dhe pajisjen e forcave të armatosura ukrainase, patrullimin e qiellit së bashku me forcën e tyre ajrore dhe forcimin e misionit ekzistues

për të siguruar Detin e Zi. "Ne duhet t'i ripërqendrojmë përpjekjet tona te paqja, duke e detyruar Putinin të ulet në tryezën e negociatave. "Ky presion i koordinuar do të bëjë një ndryshim", tha Starmer. Megjithatë, ai dhe Macron ishin të prirur të theksonin se faza operacionale ka filluar, me një seli të koalicionit të vendosur në Paris.

Diplomacia

Në frontin diplomatik, Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Marco Rubio, raportoi se Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ndau një "ide të re" mbi Ukrainën gjatë takimit të tyre në Malajzi: "Kjo nuk është një qasje e re, është një ide e re ose një koncept i ri që do t'ia paraqes presidentit për diskutim", tha Rubio, duke theksuar se nuk është diçka që "çon automatikisht në paqe, por potencialisht mund të hapë rrugën për një rrugë përpara".



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova në Evropianin e CS2, përballet me Lituaninë në çerekfinale

Ekipi i Kosovës në Counter-Strike 2 ka arritur kualifikimin në çerekfinale të Kampionatit Evropian që po mbahet në Prishtinë

në sallën “1 Tetori”. Triumfet ndaj Çekisë 2:0 dhe Danimarkës 2:1 me përmbyse ia siguruan Kosovës një vend në tetë

skuadrat më të mira të Evropës dhe duke e mbyllur fazën e grupeve në vendin e parë. E në çerekfinale Kosova do të

përballet me Lituaninë që u pozicionua e dyta në Grupin D. Kjo ndeshje luhet sot (e shtunë) me fillim nga ora 14:30. Nesër,

po ashtu, luhen edhe gjysmëfinalët nga ora 21:30, ndërsa finalja e madhe zhvillohet të dielën në mbrëmje.

PRISHTINA E RE ‘BLINDON’ MBROJTJEN ME RUDOVIÇIN DHE PRENÇIN



pasur dhe karrierë të konsoliduar në futbollin shqiptar. Elvsi së fundmi ishte pjesë e Skënderbeut ku zhvilloi 32 paraqitje në Abissnet Superiore dhe Kupën e Shqipërisë. Me përvojën dhe cilësitë e tij në qendër të mbrojtjes, ai pritët të sjellë siguri, leadership dhe karakter në vijën e fundit të skuadrës”, ka njoftuar Prishtina e Re.

Në karrierën e tij, Prençi ishte dy herë fitues i Kupës së Kosovës, një herë fitues i Superkupës së Kosovës, një herë kampion i Kategorisë së Parë në Shqipëri. Duhet cekur se skuadra Prishtina e Re e ka nisur me fitore fazën përgatitore, pasi të enjten e ka mposhtur Llapin me rezultat minimal 0-1. Golin e vetëm në këtë ndeshje e ka shënuar mesfushori Ergyn Ahmeti.

Hoxha konfirmon largimin nga Suhareka

Futbollisti Yll Hoxha edhe zyrtarisht është larguar nga skuadra e Suharekës. Lajmin e ka bërë me dije vetë Hoxha me anë të një postimi në “Facebook”. Yll Hoxha ishte pjesë e kësaj skuadre në dy vitet e fundit dhe, njëherësh, edhe kapiten i skuadrës. “Dy vjet në FC Suhareka, një vit plot suksese, tjetri plot mësimë dhe reflektim. Faleminderit Klubit FC Suhareka për mundësinë dhe tifozëve për mbështetjen në çdo çast! Mirënjohje për ata që vlerësuan angazhimin dhe profesionalizmin tim. Gati për kapitullin e radhës!”, ka shkruar Hoxha.

përvojë ndërkombëtare në Superligën e Malajzisë me Kuala Lumpur, ndërsa më parë ka qenë pjesë e disa prej klubeve nga liga elitare malazeze. Me përvojën dhe qetësinë e tij në prapavijë, ai pritët të jetë një shtyllë e rëndësishme në edicionin e parë në Superligën e Kosovës”, thuhet në njoftimin e skuadrës prishtinase. Edhe futbollisti tjetër, Elvis Prençi, luan në pozitën e mbrojtësit. Ky i fundit sezonin e kaluar ishte pjesë e Skënderbeut në Shqipëri. “KF Prishtina e Re ka kënaqësinë ta paraqesë afrimin e radhës në mbrojtje, Elvis Prençin, qendërmbrojtës me përvojë të

SHKURT

Liria përforcohet me Fetahajn

Liria e Prizrenit ka bërë një tjetër “goditje” gjatë afatit kalimtar të verës. Klubi që bën gara në Ligën e Parë të futbollit të Kosovës ka paraqitur Liridon Fetahajn si prurjen më të re. Fetahaj rikthehet te Liria pas dy sezoneve. Ai ishte te Malisheva dhe Suhareka së fundmi. “Djali i qytetit, i lindur dhe rritur në zemër të Prizrenit, Liridon Fetahaj, rikthehet aty ku i takon: te klubi i zemrës”, shkruhet në postimin e klubit.

Ernest Ross, përforcimi i parë i huaj nga Grapelandi

Skuadra e sapoinkuadruar në elitën e basketbollit të Kosovës, Grapeland, pasi ka vazhduar bashkëpunimin me trajnerin Bujar Loci dhe me basketbollistin Kujtim Ujkani, ka realizuar edhe transferimin e parë të huaj, Ernest Ross. “Me kënaqësi ju njoftojmë se kemi arritur marrëveshje me transferimin e parë të huaj për këtë sezon. Ernest Ross, 208 cm i gjatë, luan në pozitën 4 dhe së fundmi ishte pjesë e Grambling State (NCAA1) Louisiana ShBA”, thuhet në njoftimin e klubit nga Rahoveci.

Fitorja e parë për Kosovën

Kosova triumfoi ndaj Moldavisë në FIBA U16 EuroBasket 2025, Divizioni C, me rezultat 43:56 (9:13, 8:9, 17:21, 8:13). Kjo ishte fitorja e parë për vashat e Kosovës në këtë Evropian. Ndeshja nisi më mirë për vajzat e Kosovës, të cilat fituan dy çerekët e parë me rezultat 9:13 dhe 8:9, duke ndërtuar një epërsi të qëndrueshme.

Në pjesën e dytë, “dardanet” e reja vazhduan me ritëm të lartë, duke dominuar në mbrojtje dhe sulm. Ato fituan edhe çerekun e tretë dhe të katërt, duke siguruar fitoren me rezultat të përgjithshëm 43:56. Kjo ishte ndeshja e fundit në grupe për Kosovën, që shënoi edhe fitoren e parë. Të premtën është ditë pushimi, derisa Evropiani në Pejë vazhdoi të shtunën me sfidat interesante.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 KORRIK - Skuadra e promovuar në Superligë, Prishtina e Re, të enjten e paraqiti mesfushorin defensivë nga Nigeria, Amos Dadet, kurse të premtën kjo skuadër goditi duke transferuar edhe dy futbollistë të tjerë. Bëhet fjalë për Adrijan Rudoviç dhe Elvis Prençi. Mbrojtësi Rudoviç është 30-vjeçar nga Ulqini dhe ka një përvojë të madhe ndërkombëtare. “KF Prishtina e Re forcon repartin mbrojtës me Adrijan Rudoviç, mbrojtësin 30-vjeçar nga Ulqini. Adrijani i bashkohet klubit pas një

KB Bashkimi do të marrë pjesë në kualifikime të FIBA Europe Cup

PRIZREN, 11 KORRIK - Klubi i Basketbollit Bashkimi do të marrë pjesë në garën evropiane FIBA Europe Cup, me ndeshjet kualifikuese që do të zhvillohen në muajin shtator dhe tetor. Pas Trepçës që do të luajë në Ligën e kampionëve, nënkampioni i Kosovës në basketboll do të paraqitet në garën e tretë evropiane për nga

rëndësia. Bashkimi është pjesë e 29 ekipeve që janë regjistruar për këtë garë, ndërsa do të zhvillojë dy ndeshje kualifikuese për t’u futur në fazën e grupeve. Ekipi prizrenas bën pjesë në grupin e ekipeve jobartëse, ndërsa mund të përballet me ndonjërin nga tetë ekipet bartëse, si Kangoeroes Basket

Mechelen (Bel), BC Balkan (Bul), Anorthosis Famagusta (Qip), Transcom Parnu (Est), Peristeri BC (Gre), Anwil Wloclawek (Pol), Prievizda (Svk) dhe BC Dnipro (Ukr). Shorti për ndeshjet kualifikuese hedhet më 23 korrik në Munchen, derisa ndeshjet kualifikuese zhvillohen më 24 shtator dhe 1 tetor.



Jeta Zeka dhe Zyrije Pireva në Samitin Evropian të Basketbollit

Prishtinë, 11 korrik - Jeta Zeka (si gjyqtare) dhe Zyrije Pireva (si trajnere) po marrin pjesë në FIBA European Women's Basketball Summit (Samiti Evropian i Basketbollit të Vajzave), që po mbahet në Postonja të

Slovenisë. Ato janë deleguar nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), që vazhdon të investojë në kuadro, sidomos në trajnere dhe gjyqtare. “Ky event ofron trajnime për lojtaret, trajneret dhe gjyqtaret e

basketbollit. FIBA me këtë rast ofron një mundësi unike për t'i përmirësuar aftësitë e trajnereve dhe gjyqtareve perspektive nga shtetet e Evropës”, thuhet në njoftimin e FBK-së. Ky kamp zhvillimor është nën

ombrellën e FIBA Europe në bashkëpunim të Federatës së Basketbollit të Slovenisë. Kampi filloi në vitin 2007 dhe më shumë se 1 460 pjesëmarrëse kanë qenë deri më tani nga 47 Federata Evropiane.



Riola Xhemaili: Ky është emocioni më i madh që kam provuar në jetë

GENEVË, 11 KORRIK - Kaloi një vit të vështirë dhe nuk ishte titullare. Riola Xhemaili nuk u ndodh në fushë për pjesën më të madhe të kohës, ndërsa Zvicra luante shanset e saj për kualifikim në çerekfinalet e Kampionatit Evropian të Femrave, duke pasur përballë Finlandën. Në stadiumin e “Gjenevës”, skuadra helvete që është vendase në këtë turne, kishte nevojë për një barazim ndaj Finlandës, dhe plani i trajneres suedeze, Pia Sundhage, dukej se do të realizohej pa u aktivizuar fare shqiptarja nga Kosova. Gjithsesi, finlandezet ia dolën të shënonin, madje vonë. Një penallti e merituar ndihmoi mbrojtësen Natalia Kukia, që ta kalonte ekipin e tij në avantazh 1-0 dhe t'i jepte për çastin kualifikimin. Në atë kohë, erdhi çasti i Riola Xhemailit. Mesfushorja 22-vjeçare, që luan në Holandë për PSV Ajndhovenin, hyri në fushë në minutën 81-të dhe ishte shpëtimi i ekipit. Në një aksion koral, goditja e saj pranë



portës solli barazimin 1-1 në 92', dhe bashkë me të edhe kualifikimin. “Jam e lumtur. Ndihej e bekuar që shënova në fund dhe jam e lumtur që ia dolëm. Falënderoj ekipin pasi ia dolëm së bashku. Ishte një ndeshje shumë emocionuese. Ishte e bukur për shikuesit, por me shumë stres në fushë. Ishte e pabesueshme, si realizimi i një ëndrrë. Nuk mund ta përshkruaj ndjenjën që provova. Kur isha

fëmijë ëndërroja të shënoja gola të tillë, dhe ja ku ia dola. Ky është emocioni më i madh që kam provuar në jetë”, ka thënë Riola Xhemaili. Zvicra tashmë është në çerekfinale për herë të parë në histori, ndërsa në krye të Grupit A doli Norvegjia me 9 pikë, pra me tri fitore të plota, që mundi Islandën me shifrat 4-3. Shorti në katërshë mund të jetë shumë i vështirë pasi përballë pritet të jetë Spanja, kampione e botës.

Tare: M'u deshën 2-3 orë për ta bindur Allegrin

MILANO, 11 KORRIK - Massimiliano Allegri, Giorgio Furlani dhe Igli Tare kanë qenë të gjithë së bashku për një event të BMW-së, një event komercial për ta festuar partneritetin tashmë historik midis kuqezinjve dhe prodhuesit të makinave. Gjatë takimit, të tre patën mundësinë të flisin, duke ndarë ndjenjat, qëllimet dhe ambiciet e tyre të Milan ipër këtë sezon të ri. Drejtori sportiv Igli Tare zbuloi disa çaste pikante nga javët e tij të para si kuqezi. “Jam shumë i befashuar nga organizimi i klubit: që nga fillimi ndjeva gatishmërinë e të gjithëve për të na vendosur mua dhe Allegrin në pozicionin më të mirë të mundshëm për të siguruar që ky projekt të fillojë mirë”, ka thënë Tare. “Ende kemi një rrugë të gjatë për të bërë. Jemi në fazat e hershme. Duhet të jemi



të sigurt dhe të aftë të sjellim atë përvojë, atë mentalitet, atë diçka shtesë të nevojshme për të përfaqësuar një klub të lavdishëm si Milan”, ka deklaruar Tare. Ai dha një koment mbi zgjedhjen e Allegrit në stolin kuqezi: “Ne vendosëm së bashku me klubin të bënim këtë ndryshim. Na duhej një përgjigje e fortë menjëherë, me një trajner me përvojë dhe me

mentalitet fitues si Max”. “Pas një telefonate midis tij dhe meje, unë dhe Furlani shkuam në Lugano për ta takuar Allegrin. Ishte një takim i këndshëm sepse në ato dy ose tre orë kuptuam si energjinë dhe, mbi të gjitha, dëshirën për të vazhduar këtë udhëtim. Jemi të tre këtu dhe po përpiqemi të bëjmë më të mirën që mundemi”, ka deklaruar Tare.

SHKURT

Ja pse dështoi transferimi i Jasharit në Milan

Bob Madou, drejtori ekzekutiv i Club Brugges, ka folur së fundmi për tratativat me Milanin sa i takon Ardon Jasharit. Madou thekson faktin se palët janë ulur për të diskutuar, por nuk kanë gjetur gjuhën e përbashkët. “Ne jemi ulur me Milanin për mirësjellje, pa diskutuar për aspektin financiar. Nëse vjen koha kur një lojtar ka arritur vërtet në fund të një cikli dhe një klub i nivelit të lartë bën një ofertë të përshtatshme, atëherë transferimi mund të ndodhë. Nëse Jashari qëndron këtu edhe për një vit, nuk do të jetë vetëm Milani, por disa klube të nivelit të lartë që do ta kërkojnë”, ka deklaruar Madou.

Leipzig dhe Wolfsburgu në garë për Brojën

Armando Broja është ende duke kërkuar klub të ri gjatë afatit kalimtar të verës. Broja pritet të largohet nga Chelsea edhe pse ka kontratë deri në vitin 2028. Ai nuk është në planet e Enzo Marescas, sidomos pas nënshkrimit me Joao Pedron dhe Liam Delapin. Kështu, sipas gazetarit gjerman Florian Pletternberg, për Brojan janë dy klube nga Bundesliga që kanë shprehur interesim. Është RB Leipzig dhe Wolfsburgu, kurse Chelsea kërkon 20 milionë euro për të. Më favorite për të nënshkruar me Brojën nga kjo dyshe skuadrash është Leipzig, i cili nuk e ka problem të paguajë këtë shifër.

Verstappeni pas largimit të Hornerit: Kemi arritur suksese të pabesueshme

Pas 20 vitesh Christian Horner nuk do të jetë më drejtuesi i Red Bullit, skuadra që falë tij u bë e famshme në botën e Formulës 1. Një largim që erdhi në mes të sezonit, me makinën austriake shumë larg pritshmërive, që ndikoi në këtë vendim. Pas këtij lajmi ka reaguar katër herë kampioni i botës, Max Verstappen, që me Hornerin arriti të gjitha sukseset. Në rrjetet sociale Max i ka dedikuar një koment të rëndësishëm anglezit, me të cilin ka ndarë gjithë këto vite te Red Bulli. “Nga fitorja ime e parë në garë deri te katër tituj botërorë, kemi ndarë suksese të pabesueshme. Kemi fituar gara të paharrueshme dhe kemi thyer rekorde të panumërta. Faleminderit për gjithçka, Christian!”, ka shkruar holandezi.

Eliminohet Sabalenka, Anisimova në finale përballë me Swiatek

Tenistja amerikane Amanda Anisimova dhe ajo polake Iga Swiatek janë dy finalistet e grand slamit të Wimbledonit, eventit më i rëndësishëm i fushave me bar që po zhvillohet në Londër. Anisimova mbetet surpriza e këtij turneu, pasi në gjysmëfinale eliminoi numrin 1 në botë, bjellorusen Aryna Sabalenka, duke fituar 2-1 (6-4, 4-6, 6-4), në një ndeshje me emocione. Amerika, aktualisht është e 13-ta në botë, kualifikohet për herë të parë në karrierën e saj në finalen e një grand slami. Kjo është hera e parë që dy tenistet përballen mes tyre në karrierë. Për Swiatekin, ish-numri 1 në botë dhe 5 herë fituese në grand slam (4 herë në Roland Garros dhe një herë në US Open), kjo është hera e parë që arrin në finalen e Wimbledonit. Në gjysmëfinale ajo mundi pa shumë probleme 2-0 (6-2, 6-0) zviceranen Belinda Benčić. Ndeshje pa histori, komanduar nga polakja (aktualisht nr.4 në botë), që shihet favorite edhe në finale ndaj amerikanes.

Flicku aprovon transferimin e Rashfordit

Barcelona është e vendosur të nënshkruajë me Marcus Rashford dhe mundësitë për një marrëveshje me Manchester Unitedin janë shtuar ndjeshëm. Luis Diaz dhe Rashfordi janë objektivat kryesore të Barcelonës tani që Williamsi ka vendosur të qëndrojë tek

Athletic Bilbao, një marrëveshje për Diazin duket e vështirë, sidomos sepse Bayern Munichu po shtyn fort për të arritur një akord me kampionët e Ligës Premierë. Kjo po e afron Rashfordin më pranë Barcelonës, pasi një marrëveshje me Manchester Unitedin do të

ishte shumë më e realizueshme. Për më tepër, 27-vjeçari është i dëshiruar të bashkohet me kampionët e La Ligas, dhe tashmë duket se dëshira e tij mund të realizohet. Sipas raportimeve të Matteo Moretto, Hansi Flick i ka dhënë dritën e gjelbër Barcelonës për të

finalizuar një marrëveshje për Rashfordin, të cilin klubi synon ta marrë fillimisht në formë huazimi me një opsion blerjeje të përhershme verën e ardhshme. Gjithashtu, raportohet se Barcelona do të zhvillojë kontakte të reja për Rashfordin, i cili është i gatshëm të pranojë një

ulje të ndjeshme të pagës së tij te Manchester Unitedi, në mënyrë që katalanasit të mund ta përfshijnë brenda kufijve të tyre financiarë. Rashfordi e ka bërë të qartë se do të konsiderojë një transferim vetëm nëse lëvizja drejt Barcelonës mbetet një mundësi reale për të.

F2/BNJ

06/03/13182

11.07.2025

3

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A

P

PRISTINE

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, në Vendimin e datës 10/07/2025 me numër të protokollit 02/01/518 të Kryshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës: “Përgjegjës për Mekanik në Autoparkun Qendror”

Nr. i kërkuar: Një (1) pozitë, Njësia Operative Prishtinë në KRM “Pastrimi” SH.A

Numri i Referencës: DO/KJ-17/2025

Koeficienti/Paga mujore: Niveli IX

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar

Periodha Provuese: 3 muaj

1. Detvrat dhe Përgjegjësitë:

1.1 Pas pranimit të detyrave nga Udhëheqësi duhet të angazhohen në kryerjen e tyre për të siguruar riparimin e defekteve që janë në pritje duke u bazuar në urdhëresë të punës;

1.2 Është i detyruar që ta lexoj me vëmendje urdhrin e punës dhe të plotësoj të dhënat që kërkohet nga ai në Urdhëresën e Punës apo Raportet tjera përkatëse të deleguara;

1.3 Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja dhe duhet të kujdeset për pastërtinë/funksionalitetin e tyre, duke respektuar procedurat e pranim-dorëzimit;

1.4 Në mungesë të veglave apo pajisjeve të ngarkuara, punëtori detyrohet që në bazë të procedurave të brendshme t’i kompensoj ato;

1.5 Përgjegjësi duhet që të sigurohet paraprakisht se ka njohuritë e duhura për t’ju qasur punës së përshkruar në urdhëresën e punës;

1.6 Defektet e shkaktuara nga punëtori gjatë riparimit si shkak i pakujdesisë apo ushtrimit të forcës së tepruar do të procedohet për kompensim nga punëtori sipas procedurave të brendshme;

1.7 Përcjellë dhe respekton Kalendarin e Mirëmbajtjes sipas urdhëresave të deleguara apo punëve rutinore/ të zakonshme;

1.8 Është përgjegjës për riparimin e pjesëve rezervë sipas udhëzimeve nga eprorët;

1.9 Respekton uniformën dhe gjithmonë i bartë pajisjet personale mbrojtëse;

1.10 Është përgjegjës për riparim të shpejt dhe profesional të kamionit apo çdo automjeti në pronësi të kompanisë, pa vonesa të qëllimshme, të gjeturat nga riparimi i përshkruan në detaje në Urdhëresën e Punës;

1.11 Kontrollon gjendjen në hapësirën e punës dhe është përgjegjës për pastërti në punishte edhe pa urdhëresë të veçantë për pastrimin e vendeve të punës;

1.12 Është përgjegjës t’i përdor pajisjet e servisit siç janë: vinçi, presa hidraulike, makina pneumatike për demontimin dhe montimin e gomave dhe pajisjet tjera sipas urdhëresave të punës;

1.13 Angazhohet dhe reagon në të mirë të Sektorit dhe kompanisë edhe pa urdhëresë pune kurdo që shihet që ka nevojë apo në rastet kur vëren se po dëmtohet prona e kompanisë;

1.14 Asiston Kolegun/ët sipas Urdhëresës së Punës, udhëzimeve të eprorëve apo nevojës;

1.15 Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë dhe është përgjegjës për to pas ngarkimit nga depoja, bën arsyeshmërinë e montimit të çdo pjese, kujdeset për kursimin e materialit duke respektuar procedurat përcjellëse;

1.16 Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi;

1.17 Për punën e vet i raporton Udhëheqësit të Autoparkut Qendror dhe Drejtorit të Operatives

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detvërë:

✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,

✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;

✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;

✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;

✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;

✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën

✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

✓ Arsimimi i kërkuar: Shkollim i mesëm

✓ Përvoja e punës e kërkuar: 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;

✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;

✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj	✓

6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:
* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.
* në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM “Pastrimi” SH.A.

6.2 Dorëzimi i aplikacionit bëhet:
* bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com dhe
* në rastet e konkurseve të brendshme, të pozitave teknike mund të bëhet edhe në formë fizike.

7. Data dhe ora e saktë e mbvlljes së Konkursit Publik;

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 12/07/2025 deri me datën 28/07/2025.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;

✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në gjashtëdhjetë (60) pikë;

✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

10. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

F2/BNJ

Regjistrimi Regional e Mburimeve
Regjistrimi Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A /d.d.
Nr. 06103/3182 Shtojcë
Dt. 11-07-2025 3
Prishtine-Prishtine



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u kompaniji RPO "PASTRIMI" a.d. konkretno članovi 11 i 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" SH. A, u Odluci od 10.07.2025. godine sa brojem protokola 02/01/518 izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" A.D. objavi ovaj:

JAVNI KONKURS
Za popunjavanje posla

Naziv posla: "Odgovorani za mehaniku u Centralnoj floti"
Ne. Obavezno: Jedna (1) pozicija, Operativna jedinica Prishtina u RPO "PASTRIMI" SH. A
Referentni broj: DO/KJ-17/2025
Koeficijenti / Mesečne plate: Nivo IX
Trajanje ugovora o radu: Sa neodređenim vremenom
Probni rok: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1 Nakon što prihvate dužnosti od vođe, oni moraju da se uključe u njihovo obavljanje kako bi osigurali popravku nedostataka koji su u toku na osnovu radnog naloga;
- 1.2 Dužan je pažljivo pročitati radni nalog i popuniti podatke koje traži u Nalogu za rad ili drugim relevantnim delegiranim izveštajima;
- 1.3 Napunjen je delovima i radnim alatima, koje je zatražio od skladišta i mora voditi računa o njihovoj čistoći/funkcionalnosti, poštujući procedure prihvatanja i isporuke;
- 1.4 U nedostatku napunjenih alata ili opreme, radionica je dužna da ih nadoknadi na osnovu internih procedura;
- 1.5 Odgovorna osoba mora unapred osigurati da on ili ona ima odgovarajuće znanje za pristup poslu opisanom u radnom nalogu;
- 1.6 Nedostaci koje je radnik prouzrokovao tokom popravke zbog nemara ili prekomerne sile će radnik obraditi za naknadu štete u skladu sa internim procedurama;
- 1.7 prosleđuje i poštuje kalendar održavanja u skladu sa delegiranim nalogima ili rutinskim / redovnim radom;
- 1.8 Odgovoran je za popravku rezervnih delova u skladu sa uputstvima nadređenih;
- 1.9 Poštuje uniformu i uvek nosi ličnu zaštitnu opremu;
- 1.10 Odgovoran je za brzu i profesionalnu popravku kamiona ili bilo kog vozila u vlasništvu kompanije, bez namernog odlaganja, nalazi iz popravke su detaljno opisani u Nalogu za rad;
- 1.11 Kontrolise stanje na radnom mestu i odgovoran je za čistoću u radionici čak i bez posebnog naloga za PASTRIMI radnih mesta;
- 1.12 Odgovoran je za korišćenje servisne opreme kao što su: dizalice, hidraulične prese, pneumatske mašine za demontažu i montažu guma i druge opreme prema radnim nalogima;
- 1.13 Angažuje se i reaguje u korist sektora i preduzeća čak i bez radnog naloga kad god vidi potrebu ili u slučajevima kada primeti da je imovina kompanije oštećena;
- 1.14 pomaže kolegama u skladu sa radnim nalogom, uputstvima nadređenih ili potrebom;
- 1.15 Evidentira potrošnju materijala i rezervnih delova i odgovoran je za njih nakon utovara iz skladišta, vrši razumnost montaže svakog dela, brine o uštedi materijala poštujući postupke praćenja;
- 1.16 obavlja poslove i druge poslove vezane za opis radnih zadataka koje zahteva supervizor;
- 1.17 On izveštava o svom radu šefu Centralne flote i direktoru operacija

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ biti državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne prekršaje u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ Potrebno obrazovanje: Srednje obrazovanje
- ✓ Potrebno radno iskustvo: 3 godine radnog iskustva u odgovarajućoj oblasti

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Vještine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ Istraživanje, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, što pomaže u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i kako ih dostaviti

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove	✓
Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije procena posla za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, NE stariji od 3 meseca	✓

6. Kako se prijaviti na konkurs i prijaviti se:

- 6.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:
* preuzimanjem sa zvaničnog sajta na društvenoj mreži Facebook: Regionalna kompanija za otpad "PASTRIMI" AD.
* u Kancelarijama za ljudske resurse RPO "Prečišćavanje" a.d.
- 6.2 Podnošenje prijave vrši:
* se vrši samo elektronskim putem preko adrese: punesimi.krmpastrimi@gmail.com i
* U slučajevima internih takmičenja, tehničke pozicije se mogu održavati i u fizičkom obliku.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 12.07.2025. do 28.07.2025. godine.
Poslednji put za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod procene i kriterijumi ocenjivanja.

Kandidati se ocenjuju na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test).

- ✓ CV kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova;
- ✓ Pismeni test se ocenjuje do šezdeset (60) bodova;
- ✓ Intervju (usmeni test) se ocenjuje do trideset (30) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Kako obavestavati i komunicirati sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza pre verifikacije aplikacija do 7 dana;
Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuna, neskenirana dokumenta, kao i ona koja stižu nakon isteka roka konkursa neće biti razmatrana.

Bart

Privat i Arsimit t

Lart

Private Bearer of Higher Education



ALMA MATER EUROPAEA

CAMPUS COLLEGE REZONANCA

Tel: +383 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Ref. Nr. AD-2825/25,
datë 11.07.2025, Prishtinë

Në bazë të nenit 108 dhe 109 të Statutit dhe nenit 6 të Rregullores së studimeve të Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca”, Senati në mbledhjen e mbajtur më 03.07.2025 miratoi këtë:

KONKURS

P r pranimin e studentëve të nj vitin akademik 2025/2026

Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca” në Prishtinë, në vitin e parë të studimeve, në programet e studimeve Bachelor dhe Master, në vitin akademik 2025/2026, do të regjistrojë studentët në programet e akredituara të paraqitura në tabelën vijuese:

Programet studimore të akredituara	Vendimi për akreditim	Nr. i studentëve
1. Programi Stomatologji (Dr.Stom, 300 ECTS)	534/23, dt. 19.04.2023	85
2. Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)	928/22D, dt. 15.07.2022	60
3. Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)	1014/23, dt. 26.07.2023	120
4. Programi BSc Infermeri (180 ECTS)	1392/24, dt. 12.07.2024	150
5. Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)	1392/24, dt. 12.07.2024	100
6. Programi MSc Fizioterapi dhe Mjekësi Sportive (120 ECTS)	1392/24, dt. 12.07.2024	30
7. Programi MSc Farmaci (120 ECTS)	716/25, dt. 20.06.2025	100
8. Programi MSc Menaxhim i Kujdesit Shëndetësor dhe Ekonomi Shëndetësore (120 ECTS)	583/25, dt. 27.05.2025	50
9. Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)	845/25, dt. 10.07.2025	50

KUSHTET E KONKURSIT

Në konkurs mund të paraqiten kandidatët që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

- Të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës në programet që kanë përfshirë së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme profesionale mjekësore të Kosovës, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës në programet pa provim të maturës, që kanë përfshirë së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të shteteve të tjera (duhet të paraqesin certifikatën dhe diplomën për kryerjen e shkollimit 12-vjeçar, në programet e të cilave kanë dëgjuar së paku një vit Biologji, Kimi dhe Fizikë, të notifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inivacionit e Kosovës);
- të gjithë të graduarit ose të regjistruar në institucione të arsimit të lartë nga lëmenjtë e shkencave mjekësore, shkencave natyrore ose të shkencave të përafërta me programin.

Nëse kandidatët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet për lëndët Biologji, Kimi ose Fizikë sipas pikës një të paraparë në kushtet e konkursit, duhet të kalojë vlerësimin plotësues nga ajo lënd.

Në programet Master mund të paraqiten kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- kanë të përfunduar nivelin bachelor në programin adekuat të fushës, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e nivelit bachelor në programet e fushës të shteteve të tjera (aplikuesit shtetas të Republikës së Kosovës duhet të paraqesin diplomën për kryerjen e nivelit bachelor, të notifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës)

Njohja e certifikatave, përkatësisht diplomave të jashtme do të bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Ne studime mund të pranohen edhe kandidatet nga shtetet tjera ne kushte te nejta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.

Kandidati mund të regjistrohet vetëm në një program studimi në kuadër të Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca".

MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Seleksionimi do të bëhet nëpër dy faza:

- Faza e parë: Vlerësimi akademik (vlerësimi i njohurive nga lëndët e paraqitura në tabelën në vijim).
- Faza e dytë: Vlerësimi i kualiteteve personale joakademike
 - vlerësimi i shkathtësive komunikuese dhe psiko-motorike;
 - vlerësimi i qëndrimeve dhe tipareve personale;
 - vlerësimi i personalitetit.

FAZA PARË: Vlerësimi akademik

- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:
 - Suksesi në shkollën e mesme vlerësohet deri në 30 pikë
 - Suksesi në provimin pranues vlerësohet deri në 70 pikë
- Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
 - Suksesi në shkollën e mesme vlerësohet deri në 30 pikë
 - Suksesi në maturë vlerësohet deri në 20 pikë
 - Suksesi në provimin pranues vlerësohet deri në 50 pikë

Provimi pranues sipas programeve mbahet nga lëndët e paraqitura në tabelën vijuese:

Programi i studimit	Lëndët në provimin kualifikues
1. Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
2. Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
3. Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë, Matematikë
4. Programi BSc Infermieri (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
5. Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)	Biologji, Fizikë
6. Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtën dukuri, merret sukseasi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse edhe pas kësaj kemi të njëjtën dukuri, zgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni për pranimin e studentëve të rinj.

FAZA E DYTË: Vlerësimi i kualiteteve personale joakademike

- Vlerësimi i shkathtësive komunikuese dhe psiko-motorike, qëndrimeve dhe tipareve personale, si dhe personalitetit.
- Vlerësimi kryhet nga psikologët e Kolegjit. Kandidatët që kalojnë fazën e parë dhe arrijnë 20% të pikëve të parapara, njoftohen për datën dhe terminin e vlerësimit në fazën e dytë përmes emailit.

Për studimet Master, kandidatët për regjistrim do të përzgjedhen në bazë të këtyre kriterëve:

- Suksesi gjatë studimeve në nivelin bachelor (nota mesatare e studimeve) = max. 60 pikë
- Publikimeve, pjesëmarrjeve në kongrese/konferenca/takime profesionale dhe aktivitet të tjetër kërkimore-shkencore = 10 pikë
- Trajnime, kurse të tjera të kryera = 20 pikë

d. Njohja e Gjuhës Angleze (të dëshmuar me certifikatë/diplomë = 10 pikë

Në bazë të parimeve humane dhe përkushtimit për barazi, kandidatëve me nevoja të veçanta, gjatë procesit të aplikimit, do t’ua shtojë 5 pikë bonus në vlerësimin total. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me dokumentacion përkatës, të lëshuar nga institucionet kompetente.

AFATET E KONKURSIT

Paraqitja e dokumenteve fillon nga data **12 korrik 2025**, prej orës **09:00-19:00**.

Për afatin e parë, provimi pranues do të mbahet më **23 korrik 2025**, sipas këtij orari:

Termini	Programi
10:00	Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)
11:00	Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)
11:00	Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)
12:00	Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)
13:00	Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)
14:00	Programi BSc Infermieri (180 ECTS)

Paraqitja e dokumenteve për afatin e dytë të konkursit zgjatë deri më **23 shtator 2025**, kurse provimi pranues për afatin e dytë do të mbahet më **25 shtator 2025**, në orën **10:00**.

Paraqitja e dokumenteve për studimet Master bëhet deri më **04 nëntor 2024**.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca”.

Për paraqitje në konkurs kandidatët duhet të sjellin:

- Certifikatën e lindjes*
- Dëftesat e shkollës së mesme (origjinale, dublikate ose te noterizuara);*
- Diplomën e shkollës së mesme (origjinale, dublikate ose te noterizuara);*
- Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, dublikate ose te noterizuara);*
- Fletë-aplikacionin (që merret dhe plotësohet në Institucion).*
- Vendimin për njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostifikimi) nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.*
- Kopjen e leternjoftimit*

Për paraqitje në konkurs për studimet Master kandidatët duhet të sjellin:

- Certifikatën e lindjes.*
- Diplomën Bachelor.*
- Fletë-aplikacionin (që merret dhe plotësohet në Institucion).*
- Vendimin për njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostifikimi) nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.*
- Kopjen e leternjoftimit.*
- Dëshmitë lidhur me publikimet shkencore (kopjet).*
- Dëshmitë lidhur me trajnimet tjera (certifikatat/diplomat).*
- Dëshmitë për testin e gjuhës angleze (certifikata/diploma).*

Me rastin e paraqitjes në konkursin për pranim kandidatët paguajnë 30 Euro.

Në të gjitha fazat e procedurës së pranimit kandidatët me vete duhet të sjellin dokumentin e identifikimit.

Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

Nëse gjatë aplikimit online ose me rastin e dorëzimit fizik të dokumentacionit kandidati gabimisht aplikon në një program tjetër studimi, ai/ajo duhet të kërkojë nga zyrtari përkatës i TI-së ose nga zyra e pranimeve të Kolegjit që aplikimi i gabuar të anulohet, në mënyrë që t’i mundësohet aplikimi i ri nga fillimi. Kjo procedurë duhet të përfundojë para datës së mbylljes së aplikimeve.

Dorëzimi i dokumentacionit fizik për kandidatët që kanë aplikuar online do të realizohet nga data 14.07.2025 deri më 19.07.2025. Gjatë kësaj periudhe do të kryhet edhe verifikimi i dokumentacionit nga personeli administrativ i programit përkatës.

Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në uebfaqen e Kolegjit.

SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

Rezultatet preliminare të provimit pranues do të publikohen në tabelat e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Kolegjit, jo më vonë se më 24.07.2025.

Rezultati preliminar nuk konsiderohet përfundimtar dhe nuk nënkupton automatikisht pranimin e kandidatit. Pas periudhës së ankesave, në rast se ndonjë ankesë aprovohet si e bazuar, eventualisht mund të ndodhë që kandidatë të tjerë të radhiten më lart në listë dhe të fitojnë më shumë pikë sesa kandidati i pozicionuar sipas rezultateve preliminare.

Në listën e rezultateve preliminare, kandidatët do të identifikohen vetëm përmes kodit të kandidatit (të gjeneruar sipas numrit të dokumentacionit të dorëzuar), me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku përcaktohen parimet e përpunimit të të dhënave, veçanërisht minimizimi dhe siguri i konfidencialitetit.

E DREJTA DHE AFATI PER ANKESE

Kandidatët që, sipas rezultateve preliminare, renditen si të papranuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në fakultetin përkatës jo më vonë se brenda 24 orëve nga data e publikimit të rezultateve preliminare, konkretisht më 25.07.2025 deri në ora 19:00.

Pas përfundimit të afatit të përcaktuar më sipër, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave do të realizohet menjëherë pas mbylljes së afatit ligjor për paraqitjen e tyre dhe do të bëhet ekskluzivisht nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave i Kolegjit. Vendimet e këtij komisioni janë përfundimtare dhe u komunikohen kandidatëve në formë zyrtare.

Kandidatët që nuk janë pranuar mund t’i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës duke filluar nga data 26.07.2025.

Kandidatët të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë, por që nuk janë përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar për shkak të plotësimit të të gjitha vendeve të parapara në programin përkatës ku kanë aplikuar, mund të pranohen në programe të tjera studimore brenda Kolegjit, ku kanë mbetur vende të lira pas afatit të parë të konkursit, me kërkesë të kandidatit. Pranimi në këto programe do të bëhet sipas ranglistës së pikëve të grumbulluara, me kusht që kandidatët të kenë zhvilluar testet e ngjashme të provimit pranues.

Në programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të realizohet afati i dytë i provimit pranues.

SHPALLJA E REZULTATEVE PERFUNDIMTARE

Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e Kolegjit, pas shqyrtimit te ankesave, me se largu me datë 27.7.2025.

AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATET E PRANUAR

Regjistrimi i kandidateve të pranuar do te bëhet në Administratën e Kolegjit nga data 28.-31.07.2025.

Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i zbaton të gjitha kërkesat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit dhe në vend të tij në listë hyn kandidati sipas rradhës nga lista e studentëve të papranuar.

Kandidatët e pranuar, për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletë-aplikacionin për regjistrim (i cili merret në Kolegji);*
- Dokumentacionin origjinal te shkollimit paraparak*
- Një fotografi të formatit 4.5 x 6 cm;*
- Fletëpagesën për këstin e parë të pagesës së studimeve në vlerë 20% të tarifës së shkollimit për një vit akademik.*

Me rastin e regjistrimit kandidatët e nënshkruajnë Kontratën me Kolegjin.

Kandidatët mund të informohen nëpërmjet:

- Informatorit të AMECCR për vitin akademik 2025/2026 (merret në Kolegi)
- Tel. 038-544-754, prej orës 09:00 deri 19:00
- E-mail: info@rezonanca-rks.com
- Web-faqës: www.rezonanca-rks.com



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpinë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjiibiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjiibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të regullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse në studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor	Studime Master
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)	1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)	2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)	
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)	
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)	

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555

044/ 049/ 048- 500 – 878


Marrësi Ofertës : Nait Bleta

Lënda : Ymer Bleta ofertë për shitjen e pjeses ideale të bashkëpronësisë .

Unë I nënshkruari Ymer Bleta nga Prizreni cili jam bashkëpronar me ju me parcelën : 00272-7 me sipërfaqja 262 m2 ZK Prizren me pjesën time ideale 9/20 unë jam i gatshëm për të Ju shitur me cmimin total të blerjes 150.000 euro .

Sipas rregulloreve ligjore për shitjen e pasurive të paluajtshme është e nevojshme që fillimisht të ofrohet shitja bashkëpronarit cili ka të drejtën e parablerjes kështu që nëse ju hiqni dorë atëherë shitja mund të bëhet me blerës të tjerë prandaj , kjo ofertë ju dorëzohet nëse ju nuk dëshironi të blini pjesën time ideale me cmimin e mësipërm 150.000 euro që unë ju ofroj si bashkëpronar meqenëse ju keni të drejtën ligjore për ta blerë pjesën time ideale po nëse nuk e dëshironi , atëherë do të shesim blersit tjetër . Deklerata juaj në lidhje me ofertën time zgjat 30 ditë nga data e njoftimit dhe pas skadimit të afati të caktuar atëherë une do e shes blersit tjetër .

Parashtruesi Ofertës



Ymer Bleta

23.06.2025,

Prizren



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpinë 10000 Prishtinë –

Kosovë, www.kolegjiibiznesi.com, info@kolegjiibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

- Dy (2) mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
- Dy (2) mësimdhënës në programin – **Juridik**,
- Dy (2) mësimdhënës në programin – **Menaxhimi i Emergjencave**,
- Një (1) mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatës dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njoftja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjiibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjiibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjiibiznesi.com ose mund ta marrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erza Noci nga Dujaka e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 të lëshuar nga shkolla fillore “Fan S. Noli”, Dujakë.

Shqipe Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi”.

Elza Jasiqi nga Hereqi i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “Dëshmorët e Hereqit”, Hereq, Komuna e Gjakovës.

Bleona Bobi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

Gresa Krasniqi nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L